



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në vazhdimin e seancës së 58-të, të mbajtur më 28.12.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-2309 / 1 e datës 02.07.2020 , e cila shpreh pakënaqësi me punën e organeve të drejtësisë, **REFUZOHET.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesave, nuk ka elemente për veprim kompetent n; rastin e lëndës, sepse e njëjta nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar gjat ushtrimit të detyrave të autoritetit publik dhe detyrave zyrtare .

Lënda me numër 12-2309/1 të datës 02.07.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur, më datë 02.07.2020, është dorëzuar denoncim për pakënaqësi me punën e organeve gjyqësore dhe është formuar lënda me numër 12-2309/1 e datës 02.07.2020.

Në denoncim, parashtruesi kërkon nga KSHPK-ja dhe ----- të zgjidhin të gjitha palogjikshmëritë që i janë shkaktuar parashtruesit gjatë mbajtjes së një mosmarrëveshjeje gjyqësore për një vepër jo-ekzistuese.

Pas shqyrtimit të pretendimeve të lëndës, KSHPK konstaton se në lëndë nuk ka pretendime apo indikacione të qarta për veprime të paligjshme apo të palejueshme të personave zyrtar në kryerjen e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare, d.m.th. pretendimet/veprimet e denoncuara nuk përbëjnë korrupsion në pajtim të definicionit të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 1 Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. KSHPK nuk ka juridiksion të veprojë ndaj lëndëve për të cilat është ngritur padi.

Në bazë të lartpërmendurës, KSHPK-ja vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

Përgatiti: S.M

Miratoi: Mr. SH.S anëtar i KSHPK-së

KOMISIONI SHTETËRO
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska

